

# Studenti 2

Shkruani në një copë letër fjalën *themel* dhe tregojani grupit tuaj.

- Përse themeli është një pjesë e rëndësishme e një ndërtese?
- Çfarë mund të ndodhë nëse ka një problem me themelin?

Ftojani një pjesëtar të grupit tuaj të lexojë me zë të lartë 1 Korintasve 3:10 dhe vëreni pjesën tjetër të grupit të kërkojë atë që tha Pali rreth punëve të tij misionare midis korintasve.

- Çfarë tha Pali se bëri ndërkohë që punonte si misionar në Korint?
- Si mendoni ju, çfarë donte të thoshte Pali kur tha se “një tjetër ndërton mbi të”?

Ftojani një pjesëtar tjetër të grupit tuaj të lexojë me zë të lartë 1 Korintasve 3:11 dhe vëreni pjesën tjetër të grupit që të kërkojë themelin që hodhi Pali për shenjtorët në Korint.

- Çfarë themeli hodhi Pali ndërkohë që jepte mësim në Korint?
- Sipas vargut 11, kush duhet të jetë themeli i jetës sonë? (Sigurohuni që grupi juaj të përcaktojë të vërtetën vijuese: **Jezu Krishti është themeli mbi të cilin ne duhet të ndërtojmë.** Merrni parasysh që ta ftoni grupin tuaj ta shenjojë këtë të vërtetë në vargun 11.)
- Si mund të na ndihmojë ndërtimi mbi themelin e Jezu Krishtit për t’i duruar tundimet dhe sprovat? (Shih edhe Helamanin 5:12.)
- Si mund të sigurohemi se jeta jonë është ndërtuar mbi themelin e Jezu Krishtit?

Ftojani një pjesëtar/e të grupit tuaj të tregojë për dikë që ai ose ajo njih, jeta e të/së cilit/ës pasqyron se është ndërtuar mbi themelin e Jezu Krishtit. Kërkojini këtij/kësaj studentit/je që të shpjegojë mënyrën se si është bekuar ky person ngaqë ka ndërtuar mbi Krishtin.

Ftojani secilin pjesëtar të grupit të vendosë një synim që do ta ndihmojë atë të ndërtojë mbi themelin e Jezu Krishtit.

